



## SYLLABUSI I LËNDËS “KONCEPTET E TELEKOMUNIKIMIT MOBIL”

Të dhëna bazike të lëndës			
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike		
<b>Titulli i lëndës:</b>	Konceptet e telekomunikimit mobil		
<b>Programi:</b>	Teknologjitë e Informacionit dhe Telekomunikimi		
<b>Niveli:</b>	Baçelor		
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative		
<b>Viti i studimeve:</b>	3		
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2+2 (ligjërata dhe ushtrime)		
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6 ECTS		
<b>Koha / lokacioni:</b>	Të publikuara në web site të universitetit!		
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Ass. Dr. Arsim Susuri Ass. Endrit Fetahu, Ph. D. c.		
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	arsim.susuri@uni-prizren.com endrit.fetahi@uni-prizren.com		
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Ky kurs mbulon bazat e rrjeteve dhe internetit. Kursi paraqet një këndvështrim të brendshëm se si ndërtohen rrjetet dhe si komunikojnë ato përmes TCP/IP stack. Meqenëse kursi ka për qëllim t'u shërbejë studentëve me përvojë në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike, priten disa aftësi programuese kompjuterike. Temat e mbuluara përfshijnë modelin OSI dhe TCP/IP, Ethernet, Routing, adresimin IP, TCP/UDP, protokollet e rrjetit, menaxhimin e rrjetit dhe rrjetin pa tel.		
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	Qëllimi i kësaj lënde është të ofrojë për studentë një hyrje të plotë në funksionimin e sistemeve të telefonisë mobile, cila teknologji do të jetë e ardhmja e rrjeteve lokale pa tela, si dhe ndikimin e mobilitetit në aplikacione, siguri apo rrjete IP.		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	Studentët do të mund të shpjegojnë funksionet kryesore të rrjeteve të telefonisë mobile, rrjetet kompjuterike pa tela dhe roli i mobilitetit në rrjete IP. Studentët do të kuptojnë dhe mund të krahasojnë aplikimet e rrjeteve telekomunikuese mobile të ndryshme në situata të ndryshme.		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	2	2
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	1	1	1
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	2	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	10	30



Përgatitja përfundimtare për provim	5	6	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj	4	2	8
<b>Totali</b>			<b>150 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Lënda është kombinim i ligjëratave, diskutimeve, ushtrimeve numerike dhe laboratorike, ndërsa detyrat prezantohen nga asistenti në laborator.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kollokviumi 1: 40%.</li> <li>• Kollokviumi 2: 40%.</li> <li>• Projekti: 20%.</li> <li>• Ose provimi përfundimtar: 100%.</li> </ul>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Introduction to Mobile Network Engineering: GSM, 3G-WCDMA, LTE and the Road to 5G, Alexander Kukushkin, ISBN: 978-1-119-48419-6, September 2018.</li> <li>2. 5G Mobile Communications: Concepts and Technologies, 1st Edition, Saad Asif, ISBN 9781498751551, 2018.</li> <li>3. Mobile Communications and Networks, Christian Bettstetter.</li> </ol>		
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>4. Jochen H. Schiller, Mobile Communications, Second Edition. Addison-Wesley, 2003.</li> </ol>		

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në koncepte të telekomunikimit mobil	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e dytë:</i>	Aplkimet e telekomunikimit mobil, historiku, tregu, modeli i thjeshtë reference	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e tretë:</i>	Transmetimi pa tela, Kontrolli i qasjes në medium, SDMA, FDMA, TDMA, CDMA,	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e katërt:</i>	Sistemet telekomunikuese pa tela, GSM	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e pestë:</i>	Sistemet telekomunikuese pa tela, DECT, TETRA, UMTS dhe IMT-2000	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e gjashtë:</i>	Sistemet satelitore, GEO, LEO, MEO Sistemet Transmetuese	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e shtatë:</i>	LAN pa tela, IEEE 802.11	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e tetë:</i>	Testi I-rë	Konsultime rreth kollokviumit 1.
<i>Java e nëntë:</i>	LAN pa tela, HIPERLAN, Bluetooth	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e dhjetë:</i>	Shtresa e rrjetit mobil, IP mobile, rrjetet mobile ad-hoc	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Shtresa e transportit mobil, TCP tradicionale, TCP mbi rrjete pa tela 2.5/3G	Pyetje dhe Diskutim



<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Përkrahja për mobilitet, WWW, WAP	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Përkrahja për mobilitet, i-mode, SyncML, WAP 2.0	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Parashikimi, Arkitektura e rrjeteve të ardhshme	Pyetje dhe Diskutim
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Test i II-të.	Konsultime rreth kollokviumit 2.
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
<ul style="list-style-type: none"><li>• Në përgjithësi prezantimet e ligjëratave do të bëhen përmes MS PowerPoint, tabelës, përdorimit të materialeve, programeve kompjuterike dhe ushtrimeve numerike.</li><li>• Po ashtu, nga mësimdhënësit do të sigurohen edhe materiale tjera shtesë (punime shkencore, publikime, buletinet nacionale, si dhe zbulimet dhe hulumtimet e fundit).</li><li>• Në mungesë të mundësisë që puna praktike të organizohet çdo javë, në bashkëpunim me menaxhmentin e universitetit, ky aktivitet do të organizohet në ditë të caktuara në: organizata, kompani, njësitë prodhuese-përpunuese, etj.</li><li>• Gjatë çdo seancë do të organizohet qasja e bashkëbisedimit dhe bashkëparticipimit me studentë!</li><li>• Nga studentët kërkohet që të jenë të rregullt në ligjërata dhe ushtrime!</li><li>• Do të vlerësohet kontributi i studentëve kur ata bashkëpunojnë dhe participojn në ligjëratat dhe ushtrimet e lëndës!</li><li>• Ardhja e studentëve me kohë në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme!</li></ul>		